



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

VENDIM
Nr. 147 Datë 22/12/2008

PËR
PËR MIRATIM FONDI PËR SHPËRNDARJE DHURATASH PËR TË
REGJISTRUARIT E QENDRES KOMUNITARE TË MOSHËS SË TRETË DHE
PUNONJËSET E NPV INTERNATIONAL

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun për “MIRATIM FONDI PËR SHPËRNDARJE DHURATASH PËR TË REGJISTRUARIT E QENDRES KOMUNITARE TË MOSHËS SË TRETË DHE PUNONJËSET E NPV INTERNATIONAL”, bazuar në Neni Nr. 32, pika dh, e Ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore, Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë, Ligji 9836, datë 26.11.2007, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, udhëzimin Nr. 4, datë 17.01.2008 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2-008”, Udhëzimin 258, datë 15.02.2008. “Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 12, datë 18.03.2008 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Korçë” për vitin 2008”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe pas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 50 000 lekësh për dhënie dhurate të moshuarve të Qendrës Komunitare.
2. Të miratojë fondin prej 96 250 lekësh për dhënie dhurate për punonjëset e NPV International
3. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980	05	Art. 6090000	- 146250
Shtohet	00	01110	05	Art. 6020000	+ 146250

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike në Bashki dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE